

VENDIM
Nr. 168, datë 25.2.2015

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 172, DATË 26.3.2014, TË KËSHILLIT
TË MINISTRAVE, “PËR EKZEKUTIMIN E VENDIMIT TË GJYKATËS EVROPIANE
PËR TË DREJTAT E NJERIUT, DATË 15.1.2013, PËR ÇËSHTJEN NR. 49106/06,
“DELVINA KUNDËR SHQIPËRISË”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 46, të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, ratifikuar me ligjin nr. 8137, datë 31.7.1996, “Për ratifikimin e Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore”, të neneve 5 e 45, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe nenit 13, të ligjit nr. 160/2014, “Për buxhetin e vitit 2015”, me propozimin e ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Pikat 4 dhe 5, të vendimit nr. 172, datë 26.3.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për ekzekutimin e vendimit të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, datë 15.1.2013, për çështjen nr. 49109/06, “Delvina kundër Shqipërisë” të ndryshuar, ndryshohen, si më poshtë vijon:

“4. Pagesa e shumës për pjesën e mbetur të detyrimit, sipas pikës 1, të këtij vendimi, në favor të ankuesve, të bëhet nga Ministria e Financave, pas paraqitjes së të gjithë dokumentacionit të nevojshëm ligjor për kryerjen e pagesave nga buxheti i shtetit.

Për vonesën në ekzekutimin e vendimit, bazuar në pagesat pjesore të kryera, do të paguhet interesa të thjeshta, të barabarta me kursin marzhinal të huas së Bankës Qendrore Evropiane, gjatë periudhës së mospagimit, plus 3 (tre) për qind. Interesat do të llogariten nga data 8.1.2014 deri në datën e kryerjes së pagesës së plotë të principalit të detyrimit.

5. Efekti financiar për pagimin e interesave të përballohet nga fondi i kontingjencës.”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama